



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PRESIDENTI

DEKRET

PËR

**KTHIMIN E LIGJIT NR. 9206, DATË 15.03.2004
“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8461, DATË 25.02.1999 “PËR
ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR
ME LIGJIN NR. 9120, DATË 28.07.2003”**

Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës,

Dekretoj

Kthimin për rishqyrtim edhe një herë në Kuvend të ligjit nr. 9206, datë 15.03.2004 “Për një shtesë në ligjin nr. 8461, datë 25.02.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9120, datë 28.07.2003”.

**Nr. Dekretit 4188
Tiranë, më 05.04.2004**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ALFRED MOISIU**



MOTIVIMI I KTHIMIT TË LIGJIT NR. 9206, DATË 15.03.2004

**“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8461, DATË 25.02.1999
“PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 9120, DATË 28.07.2003”**

Të nderuar deputetë,

Në datë 20. 03.2004, nga Kuvendi më ka ardhur për t’u dekretuar ligji nr. 9206, datë 15.03.2004 “Për një shtesë në ligjin nr. 8461, datë 25.02.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9120, datë 28.07.2003”.

Jam dakort me rregullimin e nenit 1 të ligjit përsa i përket ngritjes së moshës së pensionit për personelin akademik me titull “profesor” në arsimin e lartë, pasi i vlerësoj lart kontributin dhe rëndësinë që ka eksperiencia profesionale dhe jetësore e këtij personeli. Nga ana tjetër, vendosa të mos e shpall këtë ligj për shkak të rregullimit të parashikuar në nenin 2 të tij lidhur me fuqinë prapavepruese. Sipas kësaj dispozite parashikohet që efektet e këtij ligji shtrihen që prej datës 1 korrik 2002. Ky përcaktim ligjor është i paqartë dhe nuk tregon se si duhet kuptuar zbatimi dhe efektet e tij. Duke parë me kujdes relacionin shpjegues të ligjit nuk ka asgjë lidhur me kuptimin dhe zbatimin e kësaj dispozite. Në eventualitetin se neni 2 i ligjit duhet kuptuar kthim në punë i individëve të cilët kanë dalë në pension në kushtet e ligjit që ndryshohet, mendoj se krijohen disa probleme kushtetuese:

1 – Me ligj krijohet pabarazi trajtimi në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës. Kjo pasi, në zbatim të ligjit në fuqi, janë krijuar apo zgjidhur marrëdhënie juridike të caktuara dhe që vihen në dyshim apo ndryshojnë me miratimin e këtij ligji.

2 – Kur ligjit i jepet fuqi prapavepruese, jo vetëm që duhet argumentuar pse, por duhet të ketë një shkak të kundërligjshëm apo të ligjshëm në formë, pasojat e të cilave kërkohet të rregullohen me ligj të posaçëm. Raste të kësaj natyre praktika parlamentare njeh disa kur ka dashur

5

të rregullojë pasoja të ardhura nga ligje të konsideruar në kundërshtim me të drejtat e individit, por jo për shkaqe të vlerësimeve të ndryshme.

Gjithsesi, pa dashur të mbaj qëndrim lidhur me sa më sipër, dhe duke patur parasysh që fuqia prapavepruese e ligjit është përjashtim nga rregullimi i përgjithshëm i zbatimit të ligjit në kohë, e kthej këtë ligj me kërkesën që Kuvendi të argumentojë vullnetin e tij për fuqinë retroaktive të këtij ligji.

3 - Gjithashtu, ligji i ardhur për dekretim, sjell dhe një faturë financiare, e cila, ndërmjet të tjerash, përfshin trajtimin financiar të personelit akademik me titull "profesor" të rikthyer në punë për shkak të efektit prapaveprues të ligjit, apo qoftë dhe për marrëdhënie të ardhshme financiare të tyre me institucionet arsimore përkatëse. Kjo faturë do të përballohet nga Qeveria. Kushtetuta në nenin 82, paragrafi 2, parashikon se "asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose pakëson të ardhurat, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave". Me sa jam unë në dijeni, Këshilli i Ministrave nuk është shprehur për këtë projektligj, duke mos u zbatuar kështu kërkesa kushtetuese për marrjen e mendimit të Këshillit të Ministrave

Përsa më sipër, dhe duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj,

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ALFRED MOISIU

